

# REZOLUTA - RESOLUTION

16/10/2018

## **“Challenges in Albania”**

TELECOMMUNICATION

SECTOR



**Sindikata e Punonjesve te Post Telekomit Shqiptar**

**Albanian Trade Union of Post-Telecom Workers**

## REZOLUTË

Ne, pjesëmarrësit në Konferencën ndërkombëtare me titull “Zhvillimet globale në sektorin e telekomunikacionit dhe sfidat për Shqipërinë“, të ndërgjegjësuar ndaj problematikës dhe sfidave të sektorit, miratojmë Rezolutën si vijon:



Duke parë:

1. Një sektor telekomunikacioni si në botë ashtu dhe në Shqipëri, në ndryshim radikal dhe të vazhdueshëm, veprimtarët e të cilit ndodhen sërisht përpara ndryshimeve vendimtare dhe nën presion të lartë;
2. Domosdoshmërinë e zgjerimit të shpejtë të rrjeteve infrastrukturore me kapacitete transferuese (FTTx, 5G) si nga pikëpamja financiare, organizative dhe e personelit, me qëllim që të përballojnë fluksin në rritjen të të dhënave që pritet të ndodhë në kuadër të aplikimeve VR (të realitetit virtual) dhe të IoT(gjithërrjetit);
3. Domosdoshmërinë e instalimit të modeleve të reja të prodhimit (SND-rrjeti i përcaktuar nga programe kompjuterike- dhe NFV-virtualizimi i funksionit të rrjetit), për të shfrytëzuar më mirë mundësitë e përshtatshmërisë së rrjeteve me bazë ofrimin e internetit;
4. Domosdoshmërinë e investimeve shtetërore nga të ardhurat e shitjes së frekuencave në modernizimin e rrjetit të telekomunikacionit, për futjen e teknologjive të reja, nën shembullin e eksperiencës së vendeve të Bashkimit Evropian;
5. Rrezikun e lënies në hije nga ofruesit e shërbimeve OTT(over the top-mbi majën), kryesisht filma, televizion dhe muzikë drejtpërsëdrejti tek konsumatori;
6. Domosdoshmërinë dhe oportunitetin e shndërrimit të kompanive të telekomunikacionit në digital telcos(kompani telekomunikacioni dixhitale), për të ofruar shërbime tregtimi(shitje me pakicë) online, E-healthcare (shërbime kujdesi shëndetësor virtual), E-shërbime financiare, E-maps, shërbime udhëtimi online, etj.



# SPPT – Sindikata e punonjësve Postë –Telekom

Albanian Trade Union of Post-Telecom Workers

Affiliated to UNI Global Union

7. Riskun e humbjes masive të vendeve të punës në një sektor që sot punëson mbi 18 mijë vetë nga mos-shndërrimi në kohë në digital telcos i kompanive të sektorit;
8. Mungesën e një vizioni, strategjie dhe plani veprimi të qartë gjithëpërfshirës për sektorin;
9. Dëshirën për dialog konstruktiv dhe bashkëpunim konkret të shprehur nga përfaqësuesit e lartë të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të pranishëm në Konferencë;
10. Praninë e ekspertizës së çmuar të Sindikatës Gjermane Ver.di, sindikatës më të madhe në Europë (me 2 milion anëtarë) të sektorit të telekomunikacioneve dhe vullnetin e përfaqësuesve të Ver.di për të ndihmuar në çdo hap Sindikatën e Post-Telekomit Shqiptar,

i kërkojmë:

## I. Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin të Kuvendit të Shqipërisë të kërkojë nga Qeveria dhe përkatësisht nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë:

I.1. të përgatisë, në bashkëpunim me Komisionin, me veprimtarët e sektorit, me Sindikatën e Post-Telekomit Shqiptar dhe me shoqërinë civile Strategjinë afatmesme 2019-2023 të Zhvillimit të Telekomunikacionit, si dhe Planin përkatës të Veprimit;

I.2. t'i kërkojë Qeverisë dhe Ministrive përkatëse që të nxisin lidhjen e kontratës kolektive të punës nga ana e punëdhënësve(kompanive) që ende nuk e kanë lidhur dhe punëmarrësve(Sindikates) për punonjësit e kompanive të telekomunikacionit. Kjo kontratë do të jetë baza për sigurimin e vendit të punës dhe të kualifikimit të kërkuar për përballimin e sfidave të reja të sektorit;

I.3. në rastin e shkurtimeve të pashmangshme të vendeve të punës për shkak të implementimit të teknologjive të reja në sektor, të kërkojë, përpara kryerjes së këtyre shkurtimeve, përgatitjen dhe miratimin nga Qeveria të një pakete sociale specifike në ndihmë të punonjësve të shkurtuar.

I.4. t'i kërkojë Qeverisë të zhvillojë forma partneriteti me kompanitë e sektorit për shërbimet e-government, e-health, e-tatime, e-education, etj., si dhe të luftojë më me efikasitet informalitetin e sektorit.



# SPPT – Sindikata e punonjësve Postë –Telekom

Albanian Trade Union of Post-Telecom Workers

Affiliated to UNI Global Union

## II. Qeverisë së Shqipërisë:

II.1. të përgatisë dhe miratojë, në bashkëpunim me veprimtarët e përmendur më lart, Strategjinë afatmesme 2019-2023 të Zhvillimit të Telekomunikacionit, si dhe Planin përkatës të Veprimit. Sindikata e Post-Telekomit Shqiptar është duke përgatitur një Strategji dhe Plan Pune alternativ, për ta orientuar Qeverinë;

II.2. të nxisë lidhjen e kontratës kolektive të punës nga ana e punëdhënësve(kompanive) dhe punëmarrësve(Sindikatës) për punonjësit e kompanive të telekomunikacionit, e cila do të jetë baza për sigurimin e vendit të punës dhe kualifikimit të kërkuar për përballimin e sfidave të reja të sektorit. Shumë shpejt Sindikata do të paraqesë një draft të Kontratës Kolektive të Punës, për ta diskutuar me kompanitë punëmarrëse të sektorit dhe shpreson mbështetjen e Qeverisë në këtë drejtim;

II.3. në rastin e shkurtimeve të pashmangshme të vendeve të punës për shkak të implementimit të teknologjive të reja në sektor, të përgatisë, përpara kryerjes së këtyre shkurtimeve, një paketë sociale specifike në ndihmë të punonjësve të shkurtuar, për ta miratuar dhe bërë operative në momentin e kryerjes së shkurtimeve;

II.4. të zhvillojë forma partneriteti me kompanitë e sektorit për shërbimet e-government, e-health, e-taxation, e-education, etj., si dhe të luftojë më me efikasitet informalitetin e sektorit.

## III. Kompanive të sektorit:

III. 1. Për ato kompani që nuk e kanë lidhur kontratën kolektive, së bashku me Sindikatën e Post-Telekomit Shqiptar, të miratojnë dhe vënë në zbatim Kontratën kolektive të Punës për punonjësit e sektorit brenda një periudhe të shkurtër kohore;

III.2. Të marrin pjesë aktivisht si në përgatitjen e Strategjisë alternative të Zhvillimit të Telekomunikacionit të Sindikatës së Post-Telekomit Shqiptar 2019-2023 dhe Planit përkatës të Veprimit, ashtu edhe të Strategjisë afatmesme 2019-2023 të Zhvillimit të Telekomunikacionit të Qeverisë së Shqipërisë, në rast se kjo e fundit do të angazhohet në përgatitjen e një strategjie të tillë.



# SPPT – Sindikata e punonjësve Postë –Telekom

Albanian Trade Union of Post-Telecom Workers

Affiliated to UNI Global Union

## RESOLUTION

We, participants in the International Conference entitled "Global Developments in the Telecommunication Sector and Challenges for Albania", aware of the issues and challenges of the sector, adopt the Resolution as follows:



Seeing:

1. A telecommunication sector both in the world and in Albania, in radical and continuous change, whose operators find themselves again in front of decisive changes and under high pressure;
2. The necessity of rapid expansion of infrastructure networks with transfer capacities (FTTx, 5G) from the financial, organizational and personnel point of view, in order to cope with the increase in the data expected to occur with the VR (virtual reality) and IoT (Internet of Things) applications;
3. The necessity of installing new production models such as SND (software-defined networking) and NFV (network function virtualization), to better use the accessibility options of internet-based networks;
4. The necessity of State investments, from the revenues of the sale of frequencies to modernize the infrastructure of the telecommunication sector for the introduction of new technologies, under the example and experience of the European Union Member Countries (Germany, etc.);
5. The risk of being overshadowed by OTT (over the top) providers, mainly film, television and music directly to the consumer;
6. The necessity and opportunity of transforming the telecommunication companies into digital telcos, so they can offer online retail services, E-healthcare, E-financial services, E-maps , online travel services, etc.



# SPPT – Sindikata e punonjësve Postë –Telekom

*Albanian Trade Union of Post-Telecom Workers*

*Affiliated to UNI Global Union*

7. The risk from non-transformation into the digital telco of sector companies of massive job losses in a sector that today employs more than 18,000 people;
8. The lack of a clear vision, strategy and action plan for the sector;
9. The desire for constructive dialogue and concrete cooperation expressed by senior representatives attending the Conference, from the Ministry of Infrastructure and Energy and the Ministry of Finance and Economy;
10. The presence of the valuable expertise of the German Trade Union Ver.di, the Europe's largest trade union (with 2 million members) in the telecom sector and the willingness of the Ver.di representatives to assist at every step the The Trade Union of Post-Telecom Workers of Albania,

we ask from:

## **I. The Committee on Production Activities, Trade and Environment of the Parliament of Albania** to request from the Government and respectively from the Ministry of Infrastructure and Energy:

I.1. to prepare, in cooperation with the Committee, with sector operators, the Trade Union of the Post-Telecom and the civil society the Medium-Term Strategy 2019-2023 on Telecommunication Development, as well as the respective Action Plan;

I.2. to request to the Government and the relevant Ministries to promote the collective employment contract by employers (companies) that have not yet signed it up and the Trade Union for the workers of telecom companies. This contract will be the basis for providing the job security and the re-qualification process required to meet new sector challenges;

I.3. in the case of unavoidable job cuts due to the implementation of new technologies in the sector, to require, prior to making such cuts, the preparation and approval by the Government of a specific social package in support of shortened staff;

I.4. to ask the Government to develop partnerships with sector companies for e-government, e-health, e-tax, e-education, etc. and to more efficiently fight the sector's informality.



# SPPT – Sindikata e punonjësve Postë – Telekom

*Albanian Trade Union of Post-Telecom Workers*

*Affiliated to UNI Global Union*

---

## **II. The Government of Albania:**

II.1. to prepare and approve, in cooperation with the aforementioned actors, the Mid-term Strategy 2019-2023 on Telecommunication Development, as well as the respective Action Plan. The Albanian Post-Telecom Trade Union is preparing an alternative Strategy and Work Plan to orient the Government;

II.2. to promote collective labor agreements between the employers (telecom companies) and the employees (the Trade Union). Soon the Trade Union of Post-Telecom will present a draft of the Collective Employment Contract to discuss with the sector companies and hopes that the Government will support this process;

II.3. in the case of unavoidable job cuts due to the implementation of new technologies in the sector, to prepare a specific social package in support of shortened staff before making such reductions, to adopt and make operational at the moment when the job cuts will occur;

II.4. to develop partnerships with sector companies for the provision of e-government services, such as e-health, e-taxation, e-education, etc., and to more efficiently combat the sector's informality.

## **III. The companies of the sector:**

III. 1. For those companies that have not signed the collective agreement, together with the Albanian Post-Telecom Union, to approve and implement the Collective Labor Contract for sector employees within a short period of time;

III.2. To actively participate in the preparation of the Alternative Strategy of Telecommunication Development 2019-2023 of the Albanian Post-Telekom Trade Union and the respective Action Plan, as well as the Medium-Term Strategy 2019-2023 of the Telecommunication Development of the Government of Albania, if the latter will engage in the preparation of such a strategy.